



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACION	
Nr./No.:	25
Data/Date:	16.01.2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	



Datë: 16.01.2019

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), nenin 8, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr. 05/2014, për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinorë si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, nenin 17, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 04, të datës 16.01.2019, bën këtë:

NJOFTIM PËR HAPJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK TË PROJEKT-HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS 2018-2026

Njoftohen qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, Kompanitë e ndërtimit dhe të gjithë të interesuarit tjerë, se me vendimin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës të marrë në mbledhjen e datës 14.01.2019 është bërë: 'Hapja e shqyrtimit publik të Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026'.

Shqyrtimi publik është i hapur tridhjetë ditë, nga data 25.01.2019 - 25.02.2019, në sallën e Kuvendit të Komunës, në ndërtesën e komunës, në rrugën 'Tahir Zemaj'.

Për sqarime, vërejtje, sugjerime apo komente lidhur me: 'Projekt-Hartën Zonale të Komunës së Fushë-Komunës', mund të drejtoheni në sallën e Kuvendit të Komunës, ku janë prezent zyrtarët e Drejtorisë së Planifikimit Urban.

Njoftimi për shqyrtim publik publikohet tri ditë radhazi në gazeta të përditshme, media televizive lokale dhe në ueb-faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

Përshëndetje!

**Kryetari i Komunës
Burim Berisha**

